

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Gaz i Lëngët për Gatim”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09122210-5, 09122110-4.

VLERA E FONDIT LIMIT: 10 463 446.54 (dhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e katërqind e dyzetë e gjashtë pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa T.V.SH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori ekonomik duhet te paraqes nje vetdeklarim sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit ku te deklaroje se disponon jo me pak se 3 punonjës të cilët janë të pajisur me **Çertifikate Profesionale** të vlefshme per instalimin e bombolave te gazit, te leshuara nga institucionet perkatese shteterore apo subjekte private te licensuara per kete aktivitet të cilët do të jenë përgjegjës për instalimin e bombolave.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** duhet të paraqesë Certifikatat profesionale të punonjesve të deklaruar.

***Argumentimi:** Kërkesa që OE duhet të ketë jo me pak se 3 punonjës të cilët janë të pajisur me Çertifikate Profesionale të vlefshme per instalimin e bombolave te gazit, te leshuara nga institucionet perkatese shteterore apo subjekte private te licensuara per kete aktivitet është vendosur pasi ata do të jenë përgjegjës për instalimin e bombolave pranë çerdheve dhe Kopshteve te Bashkisë Tiranë, bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore të paraqitura pranë autoriteteve tatimore perkatese për vitet financiare 2022, 2023, ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivit.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.2. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 2 vitet e fundit financiare 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në percaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për furnizimet e meparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së perlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

- Operatori ekonomik për të vërtetuar përvojën e meparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasishtë dhe llojin e mallrave të furnizuara,
- Operatori Ekonomik për të vërtetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat sasishtë dhe llojin e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që*

furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së se perlllogaritur te kontrates, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së perlllogaritur te kontrates, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohe, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet te paraqese Deklaratë Konformiteti CE të lëshuar nga prodhuesi për bombolat e gazit që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me ligjet e parashikuara në Republikën e Shqipërisë dhe specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

Argumentim: Kërkesa që OE duhet të paraqesë Deklaratë Konformiteti CE të lëshuar nga prodhuesi është vendosur në zbatim të kërkesave që përcaktohen në Ligjin nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve nën presion”, Neni 6, Pika 1, ku citohet: *Çdo pajisje/instalim nën presion, përpara hedhjes në treg dhe vënies në shfrytëzim, duhet të shoqërohet me deklaratën e konformitetit CE, të lëshuar nga prodhuesi, ku përfshihet edhe procedura e vlerësimit të konformitetit për fazën e shfrytëzimit, sipas moduleve apo rregullave teknike përkatëse, VKM nr. 212, datë 16.03.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe rregullave teknike për përpunimin e bombolave të gazit të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës GLN. Pika III.1 ku përcaktohet : “Tregtimi me shumicë i GLN-së, nëpërmjet bombolave, bëhet nga shoqëritë e tregtimit me shumicë, me kusht që këto bombola të plotësojnë kërkesat të sigurisë, të përcaktuara sipas rregullit teknik përkatës, përfshirë edhe pajisjen e tyre me deklaratën e konformitetit, për të gjithë sasinë e prodhuar dhe të importuar, si dhe me numrin e serisë. Bombola duhet të mbartë markimin përkatës, që demonstroi përputhshmërinë e saj me kërkesat e legjislacionit në fuqi për konformitetin”.*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument “Vërtetim përputhshmërie” për bombulat e gazit, të lëshuar nga një organ i miratuar/notifikuar i vlerësimit të konformitetit.

Argumentim: Kërkesa që OE duhet të paraqesë dokument “Vërtetim përputhshmërie” për bombulat e gazit, të lëshuar nga një organ i miratuar/notifikuar i vlerësimit të konformitetit është vendosur në zbatim të kërkesave që përcaktohen në Ligjin nr. 32/2016 “Për garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe instalimeve nën presion”, Neni 4, Pika 3; 4; 5 ku përcaktohet:

Pika 3. Përpara fillimit të procedurës së montimit të pajisjes/instalimit nën presion, operatorët ekonomikë marrin masa për vlerësimin e konformitetit të tij, nga një organ i miratuar/notifikuar për vlerësimin e konformitetit, në përputhje me rregullat teknike përkatëse.

Pika 4. Organi i miratuar/notifikuar i vlerësimit të konformitetit shqyrton përputhshmërinë e projektit të paraqitur me rregullat teknike përkatëse dhe, nëse e gjen në përputhje me to, lëshon

vertetimin e përputhshmërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore.

Pika 5. Inspektorati shtetëror përgjegjës mbikëqyr zbatimin e këtij detyrimi nga operatorët ekonomikë përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **fletë analizën e vlefshme të gazit**, lëshuar nga një laborator i akredituar në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: *Kërkesa që OE duhet të paraqesë fletë analizën e vlefshme të gazit, lëshuar nga një laborator i certifikuar në Republikën e Shqipërisë është vendosur në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për Përpunimin, për Transportin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe nënprodukteve të tyre, i ndryshuar”, Urdhërit nr. 6 datë 09.01.2015 të Ministrisë së Energjisë dhe Turizmit “Për kontrollin dhe standardet teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj.....” Pika I ku përcaktohet: Kontrolli i cilësisë së naftës dhe nënprodukteve të saj bëhet në zbatim të VKM nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse, benzine dhe diesel”, të VKM nr. 781, datë 14.11.2012 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngshme, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe për përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)” dhe të metodikave të testimit të standardeve përkatës në fuqi, të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimeve, në Laboratorin e akredituar të Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës (ISHP) ose në laboratorë të tjerë të akredituar”.*

2.3.5 Operatori Ekonomik **duhet të paraqesë autorizimin/liçensë për tregtimin e bombolave të GLN për përdorim rezidencial.**

Argumentim: *Kërkesat për autorizimin/liçensë për tregtimin e bombolave të GLN për përdorim rezidencial, është vendosur në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 i ndryshuar, kreu 2, neni 11, shkronja d), Vendimit Nr. 212 datë 16.3.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngëzuar të naftës GLN”, ligjit 10489/2011 “Për mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore”, i ndryshuar, VKM nr. 1047 datë 16.07.2008 Per disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 170 datë 25.04.2002 të Këshillit të Ministrave “Per përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhenien e lejeve dhe të autorizimeve, për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.*

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon **3 (tre) automjete transporti me masë maksimale të autorizuar jo më shumë se 3.5 ton, të pajisur me Certifikatën ADR (për transportin e lëndëve të rrezikshme)**, në pronësi ose në përdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës marrëveshje kuadër.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon 3 (tre) automjetet në pronësi ose në përdorim sipas kontratës notoriale, të vertetuara me:

- leje qarkullimi,
- çertifikate pronësie
- siguracion (TPL)

- certifikatë e kontrollit teknik
- Çertifikatën ADR(Per transportin e lendeve te rrezikshme).

Argumentim: Kërkesa që OE duhet të disponojë disponon 3 (tre) automjete transporti me masë maksimale të autorizuar jo më shumë se 3.5 ton, të pajisur me Certifikatën ADR (për transportin e lëndëve të rrezikshme), , është vendosur dike patur parasysh nevojat e AK për gaz të lëngët, në zbatim të kërkesave për furnizimin e 42 kopshteve dhe 46 çerdheve, duke patur parasysh dhe shpërndarjen e tyre gjeografike në gjithë qytetin e Tiranës si dhe në zbatim të Ligjit nr. 118/2012 “Për transportin e mallrave të rrezikshme”. Kërkesa për masën maksimale të autorizuar është vendosur sipas orinetimeve të APP datë 07.04.2023, me qëllim shmangien e konfuzionit në përgatitjen e ofertave nga OE, si dhe të KVO në vlerësimin e tyre

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet te paraqesë **“Policën e Sigurimit”** me te cilen merr persiper shperblimin e demit te shkaktuar nga defektet qe mund te vijne nga përdorimi i gazit të lëngët.

Argumentim: Kërkesa që OE duhet të paraqesë “Policën e Sigurimit” me te cilen merr persiper shperblimin e demit te shkaktuar nga defektet qe mund te vijne nga përdorimi i gazit të lëngët është vendosur në zbatim të VKM nr. 212, datë 16.03.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe rregullave teknike për përpunimin e bombolave të gazit të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës GLN, Kreu 6, Pika 8, ku përcaktohet: “Konsumatori jofamiljar që përdor bombol të mbushur me GLN, duhet të jetë i pajisur me një kontratë sigurimi me një shoqëri sigurimesh, për të garantuar rimbursimin e dëmeve të shkaktuara ndaj palëve të treta, në rast aksidenti prej këtyre sistemeve dhe bombolave të GLN-së.

2.3.8 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **deklarate** në bazë të të cilët duhet marrë përsipër instalimin e bombolave të gazit në ambientet e çerdheve dhe kopshteve si dhe duhet të deklarojë se ka të gjitha kapacitete për ndërhyrje urgjente nga personat e pajisur me certifikate profesionale në rastet emergjente kur paraqitet avari, rrezik rrjedhje gazi, etj.

Argumentim Kërkesa që OE duhet marrë përsipër instalimin e bombolave të gazit në ambientet e çerdheve dhe kopshteve si dhe duhet të deklarojë se ka të gjitha kapacitete për ndërhyrje urgjente nga personat e pajisur me certifikate profesionale në rastet emergjente kur paraqitet avari, rrezik rrjedhje gazi, etj. është vendosur në zbatim të VKM nr. 212, datë 16.03.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe rregullave teknike për përpunimin e bombolave të gazit të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës GLN, Kreu 6, pika 5 ku përcaktohet: “Shoqëritë e tregtimit me pakicë duhet të ofrojnë edhe shërbimin e mirëmbajtjes së instalimeve të bombolave me GLN”.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatën **ISO 9001:2015**, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente, të vlefshme, e cila të përfshijë objektin e prokurimit.

Argumentim: Kërkesa që OE duhet të disponojë certifikatën ISO 9001:2015, është vendosur për të siguruar që OE plotëson standardet e kërkuar në lidhje me sistemin e menaxhimit të cilësisë

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të disponojë çertifikatën ISO 14001:2015 për sistemin e menaxhimit të mjedisit, ose ekuivalente, të vlefshme, e cila të përfshijë objektin e prokurimit.

Argumentim: *Kërkesa që OE duhet të disponojë çertifikatën ISO 14001:2015 është vendosur për të siguruar që OE plotëson standardet e kërkuar në lidhje për sistemin e menaxhimit të mjedisit.*

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të paraqes një moster (bombol me gaz) sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor për artikullin e kërkuar.

Mostra (bombol me gaz) do të paraqitet në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë DPÇK me adresë “Rr. e Barrikadave, Çerdhja nr. 1 Tiranë”.

Mostra e kërkuar (bombola me gaz) duhet të ketë etiketë e cila të përmbajë përshkrimin:

- *Moster “emri i artikullit”,*
- *Datën e zhvillimit të tenderit,*
- *Emrin e ofertuesit,*
- *Nënshkrimin dhe Vullen e operatorit ekonomik*

Në sipërfaqen e bombolës duhet të pasqyrohen:

- *të dhëna për markën tregtare të shoqërisë së tregëtimit të bombolës.*
- *peshën neto dhe bruto të bombolës, të shprehur në kilogram,*
- *simbolin e flakës së ndezëshme,*
- *vitin e prodhimit të bombolës*
- *datën e kontrollit teknik të bombolës*
- *udhëzimin për përdorim të sigurtë të tyre.*

Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.

Argumentim: *Kërkesa për të dhënat e kërkuar për mostrën e paraqitur janë vendosur në zbatim të Ligjit nr. Nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, neni 7, pika 5 ku përcaktohet që: “Shoqëritë e tregtimit me shumicë të gazit të lëngshëm të naftës përgjigjen për kryerjen e kontrollit teknik dhe mbushjen e bombolave me GLN. Shoqëritë e tregtimit me shumicë, përpara futjes së bombolave në treg, bëjnë evidentimin e tyre për markën tregtare të shoqërisë, peshën neto, peshën bruto, vitin e prodhimit, datën e kontrollit teknik, si dhe udhëzimin për përdorim të sigurt të tyre”.*

Argumentim për hartimin e specifikimeve teknike:

Për hartimin e specifikimeve teknike të Gazit të Lëngët për gatim komisioni i është referuar:

- Kërkesa e vendosur në specifikimet teknike që “Gazi i Lëngët (GLN) plotëson kërkesat e standardit evropian S SH EN 589:2018 “Lëndë djegëse për përdorim shtëpiak dhe industrial GLN (Mishelë)” mbështetet në VKM Nr. 429, datë 26.06.2019, “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)”.

- Ligjit nr. 8450, date 24.02.1999 “Për Përpunimin, për Transportin dhe Tregtimin e Naftës, të Gazit dhe nënprodukteve të tyre, i ndryshuar”,
- Vendimit Nr. 212 datë 16.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngëzuar të naftës GLN”,
- Ligjit 10489/2011 “Për mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore”, i ndryshuar,
- VKM nr. 1047 datë 16.07.2008 Per disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin nr. 170 date 25.04.2002 te Keshillit te Ministrave “Per pecaktimin e procedurave dhe kushteve per dhenien e lejeve dhe te autorizimeve, per tregetin e naftes, gazit e nenprodukteve te tyre”, te ndryshuar,
- Ligjin nr. Nr.9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”,
- Ligjit nr. 32/2016 “Për sigurinë e punës të paisjeve dhe instalimeve nën presion”,
- Urdhrin nr. 128, date 08.04.2016 “Për miratimin e procedurave për kontrollin teknik të vlerësimit të konformitetit të bombolave të GLN

Për përlogaritjen e fondit limit AK është bazuar në:

- Tavanin Buxhetor të miratuar nga Bashkia Tiranë për DPÇK për vitin 2024 art. 602 sipas VKB nr.125 datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të BT për vitin 2024”, si dhe planit të miratuar të detajimit të art. 602 të vitit 2024 me shkresën nga BT nr.5904 prot, datë 06.02.2024.
- Procesverbalin e Testimit të tregut nr. 430/5 prot, datë 09.04.2024, dhe ofertave të tregut bashkëlidhur procesverbalit.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.